



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 6206 Akti
Dt. regj.26.08.2025

Tiranë më dt.27.08.2025

V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me

GJYQTAR TAULANT BANUSHI

Sot më dt. **27 Gusht 2025** përfundoj së shqyrtuari në -Dhomë Këshillimi-, kërkesën penale me nr. 6206 Akti që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Z.Ndini Tavani**.

Objekti: Vendosje sekuestro te pasurive te shtetasve:

1. Kristian Koni i biri i Skënder dhe i Fitnete i datelindjes 05.09.1980 me ID I00905051L
2. Fitnete Meta e bija e Muharrem dhe Lije e datelindjes 07.06.1947 me id E75607045E
3. Personi fizik Kristian Koni, me NIPT M31309002S
4. Personi juridik "Kriol.AL", me NIPT M12227050J
5. Personi fizik Fitnete Meta, me NIPT K61906004P
6. Personi fizik Fitnete Meta, me NIPT K31922003P

Baza Ligjore: Ligji nr.10192 date 03.12.2009”Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve te tjera nepermjet masave kunder pasurise”, i ndryshuar.

Gjykata si shqyrtoi aktet në -Dhomë Këshillimi- që ndodhen në fashikullin nr. 21510 prot.(A.A) dt. 26.08.2025, të paraqitur nga organi i prokurorisë me objekt:

-Vënie në sekuestro e pasurisë ndaj shtetasve: te sipercituar me lart,

V Ë R E N

Se organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkalles se Pare e Juridiksionit te Pergjithshem Tiranë ka paraqitur kërkesën për vendosje sekuestro preventive per interesa te procedimit pasuror nr.10 te vitit 2025, te rregjistruar per efetk te Ligji nr.10192 date 03.12.2009 ”Per

parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve te tjera nepermjet masave kunder pasurise”, i ndryshuar .

Në shqyrtimin e kësaj kërkesë e cila në bazë të Nenit 244 të Kodit të Procedurës Penale u zhvillua në dhomë këshillimi, gjykata konstaton sa vijon:

Procedimi pasuror nr. 10 datë 31.07.2025 regjistruar në ngarkim të shtetasit Kristian Koni dhe Fitnete Meta, ka filluar mbi bazën e materialit referues, ardhur me shkresën nr. 8572/K Prot, datë 07.04.2025, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për të cilin fillimisht është regjistruar referimi pasuror nr. 08, dt 08.04.2025.

Nga kryerja e verifikimeve të deritanishme në funksion të këtij procedimi pasuror ka rezultuar se:

Nga ana e Seksionit për Pastrimin e Parave dhe Asetet Kriminale, pranë Sektorit për Krimin Ekonomik dhe Financiar, në Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në zbatim të nenit 30 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 8 të ligjit nr. 10192/2009, janë referuar të dhëna lidhur me asetet dhe pasuritë që disponojnë subjektet:

Shtetasi Kristian Skënder Koni dhe Shtetasja Fitnete Muharrem Meta, për të cilët janë ngritur dyshime të arsyeshme se veprimtaria e tyre ka si burim pasuri me origjinë kriminale, që lidhet ngushtësisht me shtetasin Kristian Koni dhe historikun e tij të mëparshëm penal.

Paraprakisht, organet policore kanë relatuar si më poshtë: Bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, referohen të dhëna lidhur me aktivitetin e dyshimtë të shtetasit Kristian Skënder Koni, i datëlindjes 05.09.1980, me numër personal I00905051L.

Nga verifikimet e kryera për këtë shtetas, ka rezultuar se:

Ai ka ndryshuar gjeneralitetet nga Olsi Meta në Kristian Meta, më datë 25.05.2009, dhe më pas në Kristian Koni, më datë 11.01.2012.

Në lidhje me të dhe persona të lidhur me të, gjatë viteve 2010–2011, kanë ekzistuar korrespondenca të shumta institucionale, të nisura si rezultat i indicieve negative të referuara në burime të hapura për përfshirjen e tij të dyshuar në trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

Sipas të dhënave të administruara, shtetasi në fjalë rezulton i përfshirë në disa transaksione me elementë anomalie, në fushën e shitblerjes së pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.

Gjithashtu, sipas informacionit të disponuar nga strukturat policore, rezulton se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për përfshirjen e shtetasit Kristian Skënder Koni në një grup kriminal, i cili është arrestuar në Itali, në muajin tetor të vitit 2010, për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike, ku dyshohet se ka qenë i përfshirë dhe është arrestuar edhe vetë.

Gjithashtu, nga të dhënat e grumbulluara nga strukturat hetimore, ka rezultuar se shtetasi Kristian Koni është përfshirë në transaksione të dyshimta për pasuri të paluajtshme të kategorisë vilë rezidenciale.

Në veçanti, rezulton se ai zotëron pasurinë Vilë nr. 2-B, me përbërje 3 kate dhe sipërfaqe totale ndërtimi 391.1 m², e pajisur me pishinë, e ndodhur në zonën e Mulletit (Tiranë), pjesë e projektit rezidencial “Rolling Hills 2”. Kjo pasuri është përfutur në cilësinë e blerësit të ardhshëm, në bazë të një kontrate premtim-shitjeje të lidhur me shtetasit Vesel Demiraj dhe Rezarta Demiraj.

Çmimi i rënë dakord mes palëve ishte 280,000 euro, që do të shlyhej tërësisht nga ana e blerësit për llogari të shitësit përmes transferte bankare. Në kontratë është parashikuar që kontrata përfundimtare e shitjes të nënshkruhej brenda 30 ditëve nga momenti kur pala premtuese-shitëse të pajisej me certifikatë pronësie.

Lidhur me historikun e kësaj pasurie, rezulton se pala premtuese-shitëse, shtetasi Vesel Demiraj, e kishte porositur këtë vilë nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. 1440 rep. / nr. 1053 kol., datë 14.04.2021, të lidhur me shoqërinë “AS Construction” sh.p.k., me NIPT L91909020Q.

Sipas kësaj kontrate, çmimi i dakordësuar për pasurinë e sipërpërmendur ishte 808,000 euro, me pagesë në disa kështe. Në momentin e lidhjes së kontratës së premtim-shitjes me Kristian Konin, pala shitëse ende nuk kishte përfunduar likuidimin e detyrimeve për blerjen e kësaj pasurie.

Më datë 18.03.2024, palët kanë revokuar kontratën e premtim-shitjes, me arsyetimin se pala premtuese e blerjes nuk kishte përmbushur detyrimet kontraktuale, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme.

Pas kësaj, shtetasit Vesel dhe Rezarta Demiraj kanë lidhur një marrëveshje të re premtim-shitjeje me shoqërinë “Kriol.AL” sh.p.k., me NIPT M12227050J, e përfaqësuar nga administratori Kristian Koni, për shitjen e së njëjtës pasuri – “Vilë nr. 2-B” me sipërfaqe 391.1 m² dhe përbërje 3 kate – kundrejt çmimit 300,000 euro.

Në kontratë është përcaktuar se marrëveshja përfundimtare do të realizohej brenda 30 ditëve nga dita kur:

- Pala premtuese e shitjes të pajisej me certifikatë pronësie; dhe
- Pala premtuese e blerjes të shlyente çmimin e plotë të pasurisë.

Nga të dhënat e grumbulluara, konkludohet se:

Shoqëria “Kriol.AL” sh.p.k., e administruar nga Kristian Koni, është përfshirë në një transaksion për blerjen e kësaj pasurie me një çmim dukshëm më të ulët (300,000 euro) se sa çmimi fillestar i porosisë nga Vesel Demiraj (808,000 euro).

Në bazë të aktit noterial nr. 1946 rep. / nr. 1328 kol., është rënë dakord që shuma prej 300,000 euro të paguhet si më poshtë:

- 202,000 euro brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, në llogari të shtetasve Demiraj, pranë bankave të nivelit të dytë;
- 98,000 euro me një ose disa këste të papërcaktuara paraprakisht, në varësi të nevojave të palës blerëse dhe në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare.

Gjithashtu, është përcaktuar se dorëzimi fizik i pasurisë nga pala shitëse te pala blerëse do të kryhej pas kryerjes së pagesës së kështit të parë, në shumën 202,000 euro.

Gjithashtu, nga verifikimet e kryera, është evidentuar se shtetasi Kristian Koni ka kryer një numër të konsiderueshëm transaksionesh për shitblerje pasurish të luajtshme gjatë periudhës 2013–2024.

Ndërkohë, është konstatuar se edhe nëna e tij, shtetasja Fitnete Meta (e datëlindur më 07.06.1947, me nr. personal E75607045E), ndonëse figuron si pensioniste, ka qenë e përfshirë në disa transaksione pasurore në vlera relativisht të larta. Konkretisht:

Më datë 13.09.2014, Fitnete Meta i ka shitur palës blerëse Elton Doma pasurinë: "Apartament me sipërfaqe 124.6 m², ndodhur në Farkë, Tiranë", kundrejt çmimit 50,000 euro.

Mënyra e pagesës e deklaruar në kontratë: Shuma konsiderohet e likuiduar si detyrim që Fitnete Meta kishte ndaj Elton Domës që nga viti 2012.

Më datë 04.11.2014, Fitnete Meta ka blerë nga pala shitëse "Ndërtim Vila Co" sh.p.k. (NIPT J61813028A) pasurinë:

- Apartament me sip. 79.51 m², nr. 7/406+2-2, ndodhur në ZK 8360, në Rrugën e Barrikadave, Tiranë", për çmimin 54,000 euro.

Në kontratën noteriale nr. 996/169, datë 07.11.2006, është deklaruar se shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale, në tërësi, nga pala blerëse.

Më datë 22.10.2018, Fitnete Meta ka shitur palës blerëse Roland Shaho pasuritë:

- Apartament me sip. 79.51 m² dhe një garazh me sip. 12.5 m²", kundrejt çmimit total prej 10,823,831 lekësh.

Pagesa është realizuar nëpërmjet llogarisë bankare të noterit, sipas deklarimit në aktin përkatës.

Më datë 23.12.2019, shtetasja Fitnete Meta ka porositur një apartament dhe një vend parkimi pranë sipërmarrësit Flamur Hoxha, person fizik, me NIPT L41923001G, kundrejt çmimit 199,000 euro.

Mënyra e pagesës është deklaruar se do të kryhej me këste, në llogarinë bankare të sipërmarrësit pranë ISP Bank, me të ardhura të gjeneruara nga shitja e një apartamenti dhe garazhi në Tiranë.

Nisur nga sa më sipër, nga ana e strukturave kompetente janë kryer verifikime të mëtejshme në disa prej regjistrave zyrtarë, nga ku ka rezultuar si më poshtë:

Nga verifikimet në Regjistrin Kombëtar të Bizneseve (QKB) dhe në sistemin tatimor C@TS, është konstatuar se aktualisht shtetasit Kristian Koni dhe Fitnete Meta janë të angazhuar në aktivitet tregtar, përkatësisht:

Më datë 27.10.2021, shtetasi Kristian Koni ka regjistruar shoqërinë “Kriol.AI” sh.p.k. (ish “Sanjo” sh.p.k.), me NIPT M12227050J, me një objekt veprimtarie të gjerë, që përfshin ndër të tjera:

- Import dhe eksport të të gjitha llojeve të automjeteve dhe produkteve të ndryshme;
- Blerje dhe shitje të pasurive të paluajtshme;
- Marketing dhe reklamim për kompani kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e internetit dhe televizionit;
- Konsulencë menaxheriale, etj.

Shtetasi Kristian Koni rezulton të jetë administrator dhe aksioner i vetëm i kësaj shoqërie, duke zotëruar 100% të kuotave të kapitalit.

Nga të dhënat e sistemit tatimor C@TS rezulton se:

Gjatë periudhës 2022–2023, shoqëria “Kriol.AI” sh.p.k. ka deklaruar fitime pozitive. Sipas të dhënave të librave të shitjeve dhe blerjeve, kjo shoqëri ka pasur bashkëpunim të konsiderueshëm me kompaninë polake “Redenberg S.P.”, për shitje në vlerën rreth 96,000,000 lekë, si dhe me shoqërinë shqiptare “Shijaku” sh.p.k., pranë së cilës ka deklaruar blerje.

Shoqëria “Kriol.AI” sh.p.k. **nuk ka** pasur të punësuar të tjerë përveç administratorit Kristian Koni.

Sipas të dhënave të sistemit C@TS, ky i fundit ka pasur historik punësimi në subjektet si më poshtë:

- Inter-Alb Oil” sh.p.k. (janar 2012 – dhjetor 2012)
- ITSGA” sh.a. (mars – nëntor 2018)
- Kristian Koni” PF (janar – qershor 2023)
- Kriol.AI” sh.p.k. (tetor 2021 – shtator 2024)

Të ardhurat bruto totale të përfituara nga shtetasi Kristian Koni në formën e pagës rezultojnë në shumën 2,636,599 lekë.

Shtetasja Fitnete Meta, e regjistruar si person fizik me NIPT 1461906004P, ka një objekt aktiviteti që konsiston në tregtimin e artikujve të ndryshëm, si:

- Industrialë, ushqimore, konfeksione, fruta-perime, kozmetike, elektrike, elektronike, mobilje, bar-kafe.

Subjekti i saj është regjistruar në Ndroq, Tiranë dhe aktualisht ka status aktiv.

Referuar deklaratave të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, Fitnete Meta ka fitime që luhaten në vlerat 91,211 Lekë - 451,881 Lekë.

Sa sipër nga ana e organit procedues janë bërë verifikime me qëllim saktësimin e të dhënave të vëna në dispozicion nga organet policore, ku ka rezultuar se:

Saktesimi i te dhenave te shtetasve:

7. Kristian Koni i biri i Skënder dhe i Fitnete i datelindjes 05.09.1980 me ID I00905051L
8. Fitnete Meta e bija e Muharrem dhe Lije e datelindjes 07.06.1947 me id E75607045E

Saktësim të të dhënave pranë Gjendjes Civile në lidhje me ndryshimet e emrit:

Lidhur me nevojën për hetimin pasuror nr. 08/R/2025, si dhe veprimet procedurale që po zhvillohen nga ana e Prokurorisë në zbatim të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, për shtetasin Kristian Koni, rezulton se:

Nga verifikimet e kryera, që nga regjistrimi me Akt Lindje nr. 82, datë 07.09.1980, mbajtur në ZQGJ nr. 11, Tiranë, si dhe regjistrimi fillestar pranë prindërve sipas Regjistrat Themeltar për vitin 1974, "Rr. Durrësit", 01/102 ref., rezulton me gjeneralitetet si më poshtë:

Emri: Olsi
Mbiemri: Meta
Atësia: Skënder
Amësia: Fitnete
Vendlindja: Tiranë
Datëlindja: 05.09.1980

Shtetasi në fjalë është vendosur me vendbanim nga ZQGJ nr. 11, Tiranë, në ZQGJ nr. 9, Tiranë, më datë 23.05.2007, me të njëjtat të dhëna në gjeneralitete.

Me procesverbal nr. 77, datë 25.05.2009, ka ndryshuar emrin nga Olsi në Kristian.

Me procesverbal nr. 07, datë 11.01.2012, ka ndryshuar mbiemrin nga Meta në Koni, duke marrë mbiemrin e vajzërisë së nënës.

Kqyrja e të dhënave në sistemin TIMS:

Në sistemin TIMS, në rubrikën "Emri" u vendos emri *Kristian*, ndërsa në rubrikën "Mbiemri" u vendos mbiemri *Koni*. Pas klikimit në komandën "Kërko", në ekranin e monitorit u shfaqën gjeneralitetet e shtetasit **Kristian Koni**, i biri i Skënder dhe i Fitnete, i datëlindjes **05.09.1980**, me ID **I00905051L**. Nga verifikimi rezulton se nuk ka persona të tjerë me këto gjeneralitete.

Në të njëjtën faqe, në rubrikën "Informacion mbi identitete të mëparshme", rezulton se ky shtetas ka pasur edhe identitetet **Kristian Meta** dhe **Olsi Meta**, me datë ndryshimi **11.01.2012**.

Me komandën **CTRL+P** u krye printimi i materialeve të gjeneruara nga sistemi TIMS.

Më pas, duke përdorur komandën “I ri”, u krye kërkim me gjeneralitetet **Olsi Skënder Meta**, ku u identifikua shtetasi me gjeneralitetet: **Olsi Meta**, i biri i Skënder dhe i Fitnete, i datëlindjes **05.09.1980**, me **Numër Personal 11019051007105**.

Në të njëjtën faqe, në rubrikën “Pasaporta dhe dokumente udhëtimi”, u konstatua se ky shtetas ka qenë i pajisur me pasaportë me nr. **Z1353168**, të lëshuar më datë **15.04.2005**, me afat skadence më **14.04.2015**.

Gjithashtu, nga të dhënat e kësaj faqeje rezulton se shtetasi në fjalë ka **5 hyrje dhe 5 dalje** nga territori i Republikës së Shqipërisë, për periudhën **2006–2009**.

Në rubrikën “Të kthyer”, rezulton se shtetasi është kthyer në Shqipëri me dokumentin **leje kalimi**, më datë **20.05.2009**, nga pika e kalimit kufitar **Rinas**.

Edhe këto të dhëna u printuan nga sistemi TIMS, me komandën **CTRL+P**.

Janë kryer kërkime edhe për shtetasen **Fitnete Meta**, e bija e Muharrem dhe e Lije, e datëlindjes **07.06.1947**, me ID **E75607045E**, e cila rezulton se, gjatë periudhës **2006–2009**, ka udhëtuar në drejtim të qyteteve **Frankfurt dhe Köln**, në **Gjermani**.

Të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:

Pas verifikimit në sistemin C@t's, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon si më poshtë:

Shtetasi **Kristian Koni**, i biri i Skënder dhe i Fitnete, i datëlindjes 05.09.1980, me NID 10090505IL, rezulton i regjistruar si:

- Aplikant/pronar person fizik në subjektin Kristian Koni, me NIPT M31309002S, regjistruar më datë 09.01.2023 në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
 - Statusi aktual i subjektit: **Pezulluar** më datë 30.06.2023.
 - Ka deklaruar deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2023.
 - Nuk ka të dhëna për pasqyrat financiare, kontrole tatimore apo DIVA.
- Administrator dhe aksioner individ në subjektin Kriol.al, me NIPT M12227050J, regjistruar më datë 27.10.2021 në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
 - Statusi aktual i subjektit: **Aktiv**, që prej datës 27.10.2021.
 - Ka deklaruar deklaratat e tatimit mbi fitimin për vitet 2022, 2023 dhe 2024.
 - Ka deklaruar pasqyrat financiare për vitet 2022, 2023 dhe 2024.
 - Nuk ka të dhëna për kontrole tatimore.

Shtetasja **Fitnete Meta**, e bija e Muharrem dhe e Lije, e datëlindjes 07.06.1947, me NID E75607045E, rezulton e regjistruar si:

- Administratore në subjektin Fitnete Meta, me NIPT K61906004P, regjistruar më datë 06.07.2006 në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
 - Statusi aktual i subjektit: **Aktiv**, që prej datës 17.12.2014.
 - Ka deklaruar deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2014–2024.
 - Nuk ka të dhëna për pasqyrat financiare.

- Në sistem janë të ngarkuara dokumentet:
 - Akt konstatimi nr. 0706751, datë 24.02.2016
 - Procesverbal gjobe nr. 0186198, datë 24.02.2016
 - Akt konstatimi nr. 0805944, datë 23.08.2016
 - Akt konstatimi nr. 0503823, datë 08.09.2015
- Nuk ka të dhëna për DIVA.
- Administratore në subjektin tjetër me emërtimin Fitnete Meta, me NIPT K31922003P, regjistruar më datë 22.07.2003 në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
 - Statusi aktual i subjektit: *Pasiv*, që prej datës 22.07.2003.
 - Nuk ka të dhëna për deklarata të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, pasqyra financiare apo kontrole tatimore.



Informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:

Shtetasi Kristian Koni, me nr. ID I00905051L, ne cilesine e individit ka kryer 23 (njëzet e tre) procedura doganore importi.

Personi juridik Kriol.AL, me NIPT M12227050J, rezulton të ketë kryer 3 (tre) procedura doganore importi dhe 12 (dymbëdhjetë) procedura doganore eksporti.

Sa i përket deklarimit të parave në formë cash, metaleve apo sendeve të çmuara gjatë kalimit në pikat doganore, nuk rezultojnë deklarime të bëra nga këta shtetas dhe subjekte për periudhën mars 2004 deri më 31 maj 2025.

Të dhënat bankare të administruara për shtetasit Kristian Koni dhe Fitnete Meta, si dhe për personat fizikë dhe juridikë në zotërim të tyre:

Rezulton se ata kanë shumë llogari bankare aktive dhe lëvizje të konsiderueshme financiare.

Megjithatë, vërehet që në këto llogari kredihohen shuma të konsiderueshme në para kesh.

Referuar të dhënave paraprake të administruara në sistemin e-Albania dhe ASHK, të printuara deri në datën 22.05.2025, rezultojnë këto pasuri të regjistruara:

1. Pasuri në emër të Fitnete Muharrem Meta (NID E75607045E):

- Një pasuri ndodhet në zonën kadastrale 8210, volum 52, faqe 168, me numër pasurie 3/410-G54, me status “regjistrim i përkohshëm”, përshkruar si “sipërfaqe e përbashkët 15 m²”, me kufizim në favor të Fitnete Metës.
- Një pasuri tjetër në të njëjtën zonë, volum 52, faqe 169, numër pasurie 3/410-G55, me përshkrim identik.
- Një pasuri e tretë, volum 53, faqe 75, numër pasurie 3/410+3-36, me përshkrim: “sipërfaqe e përbashkët 36.4 m², sipërfaqe verande 31.7 m²”, me kufizim sipërfaqësor në favor të Fitnete Metës.

2. Pasuri në emër të Kristian Skënder Koni (NID I00905051L):

- Dy pasuri me status “aktiv” në zonën kadastrale 2704, njëra me numër 345/39 në rrugën “M”, Bathore, Tiranë, dhe tjetra me numër 345/32, pa përshkrim të plotë. Të dyja në indeksin e hartës K-34-100-(27-D).
- Një pasuri tjetër me status “aktiv” në zonën 2679, numër 440/242, ku pronësia ndahet mes Beloiza Arif Meta dhe shtatë personave të tjerë.
- Një pasuri me status “importuar” në zonën 8270, numër 5/499-N10, në emër të Kristian Konit, pa përshkrim të detajuar.
- Gjashtë pasuri me status “regjistrim i përkohshëm”, të gjitha në zonën 8210, me përshkrime që variojnë nga “sipërfaqe të përbashkëta 15 m²” deri në 14.6 m², në blloqe pasurish me numra përkatës 3/410-G53, G79, G80, G85, G86 dhe 3/410+3-1.

3. Pasuri në emër të subjektit juridik “Kriol.AI” (NIPT M12227050J):

- Një pasuri me status “regjistrim i përkohshëm” në zonën 1605, numër pasurie 569/25, përshkruar si “vijon nga volumni 5, faqe 59”.
- Katër pasuri me status “aktiv” në zona të ndryshme të Tiranës, përfshirë Marikaj dhe Farkë e Vogël, me numra 197/22, 197/14, 197/16/1 dhe 197/24. Disa pa përshkrim të plotë, të tjera me përshkrime të pronave në rrugë të caktuara.

4. Automjete të regjistruara në emër të Kristian Skënder Konit (NID I00905051L):

- Autoveturë me targa **AB528JJ**, markë SMART, model FORTWO COUPE, nr. shasie WME4533621K252205, ngjyrë e zezë.
- Autoveturë me targa **KRIOL01**, markë LAND ROVER, model RANGE ROVER, nr. shasie SALKA9BWXRA224730, ngjyrë jeshile e errët.

Në funksion të këtij hetimi janë evidentuar edhe disa korespondenca lidhur me veprimtarinë kriminale të shtetasit Kristian Koni, ku theksohet se në të dhënat e Interpol-it ky shtetas rezulton i përfshirë në aktivitet kriminal për veprën penale “Trafik droge” gjatë periudhës 2007–2012 në Itali.

Gjithashtu, shtetasi njihet me alias:

- Zdanaivicius Ramunas (lindur më 28.07.1980)
- Kelys Zydrunas (lindur më 29.04.1987)

Përveç kësaj, ai ka ndryshuar emrin dhe mbiemrin dy herë në Shqipëri, sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke u regjistruar si Olsi Meta dhe Kristian Meta.

Në bazë të materialeve hetimore dhe të dhënave të administruara nga organet ligjzbatuese dhe institucionet përkatëse, ka dyshime të arsyeshme se pasuritë e përmendura më sipër kanë origjinë të dyshuar kriminale dhe lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e paligjshme të shtetasve Kristian Skënder Koni dhe Fitnete Muharrem Meta.

Shtetasi Kristian Koni rezulton i përfshirë në një grup kriminal që vepronte në trafikimin e lëndëve narkotike në Itali gjatë periudhës 2007–2012, si dhe janë konstatuar ndryshime gjeneralitetesh dhe përfshirje në transaksione me pasuri të luajtshme dhe të

paluajtshme me anomali financiare dhe veprime të dyshimta të lidhura me burime kriminale.

Gjithashtu, shtetasja Fitnete Meta, e cila figuron si pensioniste, është përfshirë në transaksione me vlera të konsiderueshme pasurore që nuk korrespondojnë me statusin dhe të ardhurat e saj të deklaruar.

Në këtë kontekst, pasuritë në emër të tyre dhe subjektit juridik "Kriol.AI" shpk, përfaqësuar nga Kristian Koni, janë dyshuara si pasuri të fituara ose të përfituara në mënyrë të paligjshme dhe për pasojë, vendosja e masës së sekuestros preventive është e domosdoshme për të:

- Siguruar ruajtjen dhe mos shpërndarjen apo shkatërrimin e këtyre pasurive gjatë kohës së hetimit;
- Parandaluar përdorimin e tyre për qëllime kriminale ose transferimin në emra të tjerë për fshehje të origjinës së tyre;

Po kështu, sipas nenit 3, pika 2, gërma "a" e këtij ligji, dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për pasuritë e personave sipas nenit 1, që zotërohen nga të afërmit e të dyshuarit.

Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, konstatohet se plotësohen njëkohësisht dy kriteret e përgjithshme që kanë të bëjnë me:

Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicie që tregojnë se personat mund të jenë përfshirë në veprimtari kriminale dhe 2. Zotërimi i pasurive apo të ardhurave, shpërpjestimore, në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme të deklaruar dhe as nuk përligjen prej tyre; si dhe të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat "a" dhe "b" të këtij neni.

Në rastin konkret plotësohet pika a e këtij neni, pra ekziston një rrezik real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji, pasi nëse subjekti i dyshuar "pronar" nëse vihet në dijeni të ekzistencës së një procedimi në ngarkim të tij, mund të kryejë veprime juridike për tjetërsimin e pasurisë së tij.

Ndaj pasuritë e identifikuar në emër të shtetasit të dyshuar Kristian Koni dhe Fitnete Meta, duhet t'i nënshtrohen sekuestros, pasi plotësohen të gjitha kriteret ligjore të analizuar më lart.

Duke qene se vazhdimi i metejshe i kesaj situate qe lidhet me shitjet e pasurive ne fjale, nisur nga problematika mes paleve, duke qene pra para elementeve te figures se vepres penale per te cilen eshte regjistruar procedimi pasuror per efekt te Ligji nr.10192 date 03.12.2009"Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar, trafikimit,

korupsionit dhe krimeve te tjera nepermjet masave kunder pasurise", i ndryshuar, cmojme se ndodhemi ne kushtet kur duhet vendosur sekuestro preventive.

Gjykata duke vlerësuar se ka të dhëna të mjaftueshme që vërtetojnë se vazhdimi i metejshëm i kesaj situate që lidhet me shitjet e pasurive në fjalë, nisur nga problematika mes paleve, duke qenë pra para elementeve të figures së vepres penale për të cilën është regjistruar procedimi pasuror për efekt të Ligji nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korupsionit dhe krimeve të tjera nepermjet masave kunder pasurise", i ndryshuar, cmojme se ndodhemi ne kushtet kur duhet vendosur sekuestro preventive.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata bazuar në Nenin 274 të K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e kërkesës.

-Vendosjen e sekuestros së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme si më poshtë vijon:.

1. Pasuria nr. 3/410-G54, në emër të Fitnetë Muharrem Meta, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 168, me indeks harte Tr-N-8.
2. Pasuria nr. 3/410-G55, në emër të Fitnetë Muharrem Meta, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 169, me indeks harte Tr-N-8.
3. Pasuria nr. 3/410+3-36, në emër të Fitnetë Muharrem Meta, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 53, faqe 75, me indeks harte Tr-N-8.
4. Pasuria nr. 440/242, në emër të Kristian Skënder Koni etj., e cila ndodhet në ZK 2679, volumni 26, faqe 86.
5. Pasuria nr. 345/39, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 2704, volumni 33, faqe 48, me indeks harte K-34-100-(27-D).
6. Pasuria nr. 345/32, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 2704, volumni 32, faqe 173, me indeks harte K-34-100-(27-D).
7. Pasuria nr. 5/499-N10, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8270, volumni 64, faqe 174, me indeks harte Tr-T-11.
8. Pasuria nr. 3/410-G53, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 167, me indeks harte Tr-N-8.
9. Pasuria nr. 3/410-G79, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 193, me indeks harte Tr-N-8.
10. Pasuria nr. 3/410-G80, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 194, me indeks harte Tr-N-8.
11. Pasuria nr. 3/410-G85, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 199, me indeks harte Tr-N-8.
12. Pasuria nr. 3/410-G86, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 52, faqe 200, me indeks harte Tr-N-8.
13. Pasuria nr. 3/410+3-1, në emër të Kristian Skënder Koni, e cila ndodhet në ZK 8210, volumni 23, faqe 40, me indeks harte Tr-N-8.
14. Pasuria nr. 569/25, në emër të "Kriol.AL" sh.p.k., e cila ndodhet në ZK 1605, volumni 17, faqe 169, me indeks harte K-34-100-(28-D).

15. Pasuria nr. 197/22, në emër të "Kriol.AL" sh.p.k., e cila ndodhet në ZK 1605, volumni 19, faqe 124, me indeks harte K-34-100-(28-B).
16. Pasuria nr. 197/14, në emër të "Kriol.AL" sh.p.k., e cila ndodhet në ZK 1605, volumni 5, faqe 226, me indeks harte K-34-100-(28-B).
17. Pasuria nr. 197/16/1, në emër të "Kriol.AL" sh.p.k., e cila ndodhet në ZK 1605, volumni 12, faqe 182, me indeks harte K-34-100-(28-B).
18. Pasuria nr. 197/24, në emër të "Kriol.AL" sh.p.k., e cila ndodhet në ZK 1605, volumni 19, faqe 126, me indeks harte K-34-100-(28-B).
19. Automjet me targa AB528JJ, marka SMART, modeli FORTWO COUPE, me nr. shasje WME4533621K252205, ngjyrë e zezë.
20. Automjet me targa KRIOL01, marka LAND ROVER, modeli RANGE ROVER, me nr. shasje SALKA9BWXRA224730, ngjyrë jeshile e errët.
21. Llogaritë bankare pranë bankave të nivelit të dytë si dhe personat fizik/juridik, në emër dhe për llogari të:
 - individit Kristian Koni, me NID I00905051L
 - Personi fizik Kristian Koni, me NIPT M31309002S
 - Personi juridik "Kriol.AL", me NIPT M12227050J
 - individit Fitnete Meta, me NID E75607045E
 - Personi fizik Fitnete Meta, me NIPT K61906004P
 - Personi fizik Fitnete Meta, me NIPT K31922003P

-Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Brendshme Tiranë.

-Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet oficeri i policisë gjyqësore **Renato Ibrahim** i mbështetur nga DVP Tiranë.

U shpall sot, në Tiranë më datë 27 Gusht 2025.

GJYQTAR

TAULANT BANUSHI

